



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21649 Prot.

Lezhë, më 18 . 12 . 2025

VENDIM

Nr. 116, Datë 15. 12. 2025

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIN
E QIRASË PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, VKM nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë dhe tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr. 459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”. Gjithashtu, bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Lezhë Nr. 64, datë 03.09.2024 “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit dhe programeve sociale të strehimit”, Vendimin Nr. 98, datë 30.10.2025 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”, dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Lezhë Nr. 20788/1 prot., datë 05.12.2025, “Për miratimin e listës së familjeve përfituese për programin e subvencionit të qirasë për vitin 2026”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e familjeve që përfitojnë subvencionin e qirasë për vitin 2026 me numër rendor 97, sipas tabelës Nr. 3 bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e këtij vendimi.
2. Në zbatim të këtij vendimi, Bashkia Lezhë t’i paraqesë kërkesën Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për financimin e subvencionit të qirasë nga buxheti i shtetit, me afat kohor 1 vjeçar.
3. Atyre familjeve, të cilat gjatë periudhës së trajtimit dalin jashtë kriterëve, duke ndryshuar situatën social-ekonomike, u ndërpritet menjëherë përfitimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI

